



Numri i lëndës: 2022:045281
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05464160

C.nr.98/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË V., Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, me bashkëpunorën profesionale Lumturije Fetahu, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditëses Korporatës Enejtike të Kosovës (KEK), - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton” nr. 3, ndertesa e Elektrokosoves Kati II, nr; 5, kundër të paditurit S.A., nga V. Rr, Mustafë Koka”, nr.13, lidhur me padinë për kompensimin e damit material, të ngarkuar në shumë prej 441.45 € euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 14.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË MOSBINDJES**

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Korporatës Enejtike të Kosovës (KEK), - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), me seli në Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr. 3, ndertesa e Elektrokosoves Kati II, nr; 5,

II. DETYROHET i padituri S.A., nga V., që paditëses në emër të dëmit të shkatuar material, për shkak të shfrytëzimit të energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 441.45 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë (data e paraqitjes së padisë 02.03.2022) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

III. DETYROHET i padituri, që paditëses në emër të kompenzimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj shumën prej 20.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja Korporatës Enejtike të Kosovës (KEK), - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), me seli në Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr. 3, ndertesa e Elektrokosoves Kati II, nr; 5, në këtë gjykatë, më datë 02.03.2022, ka dorëzuar padi kundër të paditurit S.A., nga V., me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, të ngarkuar në shumë prej 441.45 € euro, duke theksuar se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas Aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Gjilan- dega në V. P.nr.79/2018 të datës 21.04.2021, i cili ka marrë formën e prer me datë 28.05.2021. Paditësja ka parashtruar prova

duke i propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi dhe që të obligohet i padituri në pagimin e borxhit në shumën e lartcekur.

Me aktvendimin C.nr.98/2022, datë 05.10.2023, të marr në bazë të nenit 394, të LPK-së, gjykata e ka ftuar të paditurin që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha provat materiale, të paraqes përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcënim të pasojave procedurale.

I padituri pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata në kuadër të autorizimeve ligjore, e në kuptim të dispozitave nga 150 paragrafi 1, nën pika (a), (b) dhe (c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se “Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”, e pasi vlerësoi kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë, gjeti se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë.

Gjykata i vlerësoi të gjitha kushte për nxjerrjen e aktgjykimit siç parashohin dispozitat nga neni 150 paragrafi 1, nën pika (a), (b) dhe (c), të LPK-së, dhe atë se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, dhe se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, në rastin konkret nga provat e dorëzuar me padi, respektivisht në bazë të Aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Gjilan- dega në V. P.nr.79/2018 të datës 21.04.2021, i cili ka marrë formën e prer me datë 28.05.2021, vërtetohet fakti i padituri S.A., nga V., në bazë të aktgjykimeve penale të lartëcekur është shpallur fajtor për veprën penale “vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314.par. 6 lidhur me par. 1, të KPRK-së, nga se me qëllim që vetit ti sjellë përfitime të kundërligjshme pasurore, në mënyrë të paautorizuar e ka shfrytëzuar energjinë elektrike, e të cilin fakt e kanë vërtetuar punëtorët e autorizuar të KEDS-it dhe se paditëses i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 441.45 € euro .

Gjykata në kuptim të dispozitave të cituara nga neni 150, i LPK-së e në lidhje me dispozitat nga neni 136 paragrafi 1, i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve (tutje LMD-së), ku përcaktohet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, si dhe në nenin 245 paragrafi 1, të LMD-së, ku përcaktohet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.”, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën ligjore, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382, të LMDsë.

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e që në rastin konkret gjykata erdhi në përfundim se paditëses duhet t’i njihen shpenzimet e procedurës dhe atë në shumë prej

Numri i lëndës:

2022:045281

Datë:

18.03.2024

Numri i dokumentit:

05464160

20.00 euro, shumë kjo e paguar në emër të taksës gjyqësore për parashtrimin e padisë në gjykatë.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në dispozitën e nenit 150, e lidhur me dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:045281, 14.03.2024
C. nr.98/2022**

Gj y q t a r i
Alush Sinani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate

Numri i lëndës:

2022:045281

Datë:

18.03.2024

Numri i dokumentit:

05464160